



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Ekstra 68

Gusht

2010

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.968, datë 30.9.2009	Për një ndryshim në vendimin nr.342, datë 8.4.2009 të Këshillit të Ministrave “Për kontributin e Qeverisë Shqiptare për ringritjen e kapaciteteve të Forcave të Armatosura të Irakut”.....	3
Vendim i KM nr.981, datë 12.10.2009	Për lirim nga detyra.....	3
Vendim i KM nr.985, datë 14.10.2009	Për lirim dhe emërim në detyrë.....	3
Vendim i KM nr.989, datë 8.10.2009	Për lirim dhe emërim në detyrë.....	4
Vendim i KM nr. 996, datë 20.10.2009	Për lirim dhe emërimin në detyrë të prefektit të qarkut të Kukësit.....	4
Vendim i KM nr.1019, datë 8.10.2009	Për ngarkimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme për ndjekjen e procesit të integritetit të vendit në Bashkimin Europian.....	4
Vendim i KM nr.1024, datë 8.10.2009	Për miratimin e raportit kombëtar periodik për paktin ndërkombëtar për të drejtat ekonomike, shoqërore dhe kulturore.....	5
Vendim i KM nr. 1045, datë 23.10.2009	Për emërimin në detyrë të prefektit të qarkut të Lezhës.....	5
Vendim i KM nr.1046, datë 23.10.2009	Për lirim dhe emërim në detyrë.....	5
Vendim i KM nr.1047, datë 23.10.2009	Për emërim në detyrë.....	6

Vendim i KM nr.1048, datë 23.10.2009	Për emërim në detyrë.....	6
Vendim i KM nr.1049, datë 23.10.2009	Për lirim dhe emërimin në detyrë të prefektit të qarkut të Fierit.....	6
Vendim nr.1050, datë 23.10.2009	Për lirim dhe emërimin në detyrë të prefektit të qarkut të Durrësit.....	7
Vendim i KM nr. 1059, datë 21.10.2009	Për lejimin e zhvillimit të procedurave të disa prokurimeve...	7
Vendim i KM nr.1061, datë 21.10.2009	Për miratimin e fondit të shpenzimeve, për vitin 2010, për Entin Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe të Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura.....	8
Vendim i KM nr. 1063, datë 21.10.2009	Për dhëne ndihme financiare familjeve të të ndjerëve Shkëlzen Destan Dobrushit dhe Ramadan Sadik Hilaj, ish- punonjës policie të vrarë në krye të detyrës.....	8
Vendim i KM nr. 1072, datë 21.10.2009	Për lirim dhe emërim në detyrë.....	9
Vendim i KM nr.1073, datë 21.10.2009	Për lirim dhe emërim në detyrë.....	9
Vendim i KM nr.1074, datë 21.10.2009	Për emërim në detyrë.....	9
Vendim i KM nr.1078, datë 28.10.2009	Për lirim dhe emërim në detyrë.....	10
Vendim i KM nr.1087, datë 28.10.2009	Për miratimin e planit kombëtar të veprimit për dekadën e përfshirjes së romëve, 2010-2015.....	10
Vendim i KM nr.1111, datë 13.11.2009	Për miratimin e përdorimit të fondeve buxhetore nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për financimin e shpenzimeve për zgjedhjet e pjesshme për pushtetin vendor, për disa bashki e komuna, më 15 nëntor 2009.....	10
Vendim i KM nr.1112, datë 13.11.2009	Për një ndryshim në vendimin nr.115, datë 2.2.2009 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2009, në disa ministri dhe institucione qendrore”, të ndryshuar.....	11
Vendim i KM nr.1118, datë 13.11.2009	Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i linjës 220 kv, Tec i Ri, Vlorë-nënstacioni 220/110/35 kv, Babicë, Vlorë.....	12
Vendim i KM nr.1121, datë 13.11.2009	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2009, miratuar për Ministrinë e Turizmit, Kultutës, Rinisë dhe Sporteve, për shpërblimin e peshëngritësve, Romela Begaj e Erkand Qerimaj, dhe të trajnerëve të tyre, Hektor Shaqiri e Zef Kovaçi, për rezultatet e larta, që kanë arritur në Lojërat Mesdhetare, Pescara 2009.....	13

Vendim i KM nr.1138, datë 18.11.2009	Për miratimin e një fondi shtesë për kompensimin e dëmeve në banesat e dëmtuara nga rrëshqitja masive, në lagjen Qafë-Dardhë të fshatit Gur-Shpatë, komuna Polis, rrethi Librazhd, qarku Elbasan.....	13
Vendim i KM nr.1139, datë 24.11.2009	Për përcaktimin e numrit të automjeteve dhe të shoferëve në dispozicion të ministrive dhe të institucioneve qendrore.....	15
Vendim i KM nr.1140, datë 25.11.2009	Për propozimin Kuvendit të Republikës së Shqipërisë lirim nga detyra të anëtarëve të Këshillit Drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve dhe emërimin në detyrë të anëtarëve të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.....	16
Vendim i KM nr.1152, datë 4.12.2009	Për emërim në detyrë.....	17
Vendim i KM nr.1204, datë 11.12.2009	Për një ndryshim në vendimin nr.659, datë 3.10.2007 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e kryerjes së procedurave të prokurimit me mjete elektronike”.....	17
Vendim i KM nr.1213, datë 11.12.2009	Për lirim dhe emërimin në detyrë të kryetarit të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë.....	17
Vendim i KM nr.1215, datë 16.12.2009	Për një shtesë në vendimin nr.1151, datë 25.11.2009 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”	18
Vendim i KM nr.1225, datë 11.12.2009	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2009, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të kurimit të z.Fadil Mehmetaj, në Gjermani.....	18
Vendim i KM nr.1228, datë 16.12.2009	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2009, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të kurimit të z.Dejvis Korreci, në Itali.....	19
Vendim i KM nr.1229, datë 16.12.2009	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2009, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të kurimit të znj.Nurie Maloku, në Turqi.....	19
Vendim i KM nr.1244, datë 21.12.2009	Për lirim dhe emërim në detyrë.....	20
Vendim i KM nr.1247, datë 24.12.2009	Për kalimin në përgjegjësi administrimi Institutit të Statistikave (INSTAT) të disa mjediseve, në administrim të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.....	20
Vendim i KM nr.1249, datë 16.12.2009	Për organizimin, funksionimin, përbërjen dhe përcaktimin e masës së shpërbimit të anëtarëve të Komitetit Ndërsektorial për Mbrojtjen e Shëndetit nga Produktet e Duhanit (KNMSHPD).....	23
Vendim i KM nr.1251, datë 29.12.2009	Për lejimin e botimit të kontratës së nënshkruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, si autoritet kontraktor.....	24

Vendim i KM nr.1252, datë 7.12.2009	Për emërim në detyrë.....	24
Vendim i KM nr.1257, datë 23.12.2009	Për një shtesë fondi bashkisë Berat, për dhënie ndihme financiare familjes së shtetasit Artur Kaja, si pasojë e zjarrit të rënë në banesë, më 22.11.2009.....	24
Vendim i KM nr.1262, datë 29.12.2009	Për emërim në detyrë.....	25
Vendim i KM nr.1276, datë 23.12.2009	Për disa shtesa në vendimin nr.824, datë 6.12.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e institucioneve të autorizuara për verifikimin, në mënyrë elektronike, të gjendjes gjyqësore, si dhe të formularit të vetëdeklarimit”, të ndryshuar.....	25
Vendim i KM nr.1288, datë 23.12.2009	Për emërimin në detyrë të drejtorit të përgjithshëm të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.....	26
Udhëzim i MMPAU nr.3, datë 19.11.2009	Për metodologjinë e vlerësimit të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis.....	26

VENDIM
Nr.968, datë 30.9.2009

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.342, DATË 8.4.2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KONTRIBUTIN E QEVERISË SHQIPTARE PËR RINGRITJEN E
KAPACITETEVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË IRAKUT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7 të nenit 14 të ligjit nr.8671, datë 26.10.2000 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Sasia “38 200”, e përmendur në pikën 2, të tabelës nr.1, që i bashkëlidhet vendimit nr.342, datë 8.4.2009 të Këshillit të Ministrave, bëhet “382 000”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.981, datë 12.10.2009

PËR LIRIM NGA DETYRA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 6 të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Gent Strazimiri, zëvendësministër i Brendshëm, lirohet nga kjo detyrë.
 2. Z. Florian Mima, zëvendësministër i Financave, lirohet nga kjo detyrë.
 3. Z. Sherefedin Shehu, zëvendësministër i Financave, lirohet nga kjo detyrë.
 4. Znj. Pavlina Hoti, zëvendësministre e Drejtësisë, lirohet nga kjo detyrë.
 5. Znj. Adriana Gjonaj, zëvendësministre e Arsimit dhe Shkencës, lirohet nga kjo detyrë.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.985, datë 14.10.2009

PËR LIRIM DHE EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të neneve 95, pika 2, e 100 të Kushtetutës, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Znj. Antoneta Malaj, Drejtore e Përgjithshme e Agjencisë Telegrafike Shqiptare, lirohet nga kjo detyrë.
 2. Z. Artur Zheji emërohet Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Telegrafike Shqiptare.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.989, datë 8.10.2009

PËR LIRIM DHE EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 6 të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministarve”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Ndue Preka, zëvendësministër i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, lirohet nga kjo detyrë.
 2. Z. Tokli K.Thomaj emërohet zëvendësministër i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 996, datë 20.10.2009

PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË DETYRË TË PREFEKTIT TË QARKUT TË KUKËSIT

Në mbështetje të neneve 100 e 114 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr. 8927, datë 25.7.2002 “Për prefektin”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z.Lulzim Aliaj lirohet nga detyra e prefektit të qarkut të Kukësit.
 2. Z.Elez Maçi emërohet prefekt i qarkut të Kukësit.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1019, datë 8.10.2009

PËR NGARKIMIN E ZËVENDËSKRYEMINISTRIT DHE MINISTËR
I PUNËVE TË JASHTME PËR NDJEKJEN E PROCESIT TË INTEGRIMIT TË VENDIT NË
BASHKIMIN EUROPIAN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 5 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Zëvendëskryeministri dhe Ministër i Punëve të Jashtme ndjek me përparësi të gjithë procesin e integrimit të vendit në BE dhe atë të liberalizimit të vizave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1024, datë 8.10.2009

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT KOMBËTAR PERIODIK PËR
PAKTIN NDËRKOMBËTAR PËR TË DREJTAT EKONOMIKE, SHOQËRORE DHE
KULTURORE**

Në mbështetje të neneve 100 e 122 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.7511, datë 8.8.1991 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në paktin ndërkombëtar për të drejtat ekonomike, shoqërore dhe kulturore”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e raportit kombëtar periodik për paktin ndërkombëtar për të drejtat ekonomike, shoqërore dhe kulturore, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 1045, datë 23.10.2009

PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË PREFEKTIT TË QARKUT TË LEZHËS

Në mbështetje të neneve 100 e 114 të Kushtetutës, dhe të nenit 4 të ligjit nr.8927, datë 25.7.2002 “Për prefektin”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Pal Dajçi emërohet prefekt i qarkut të Lezhës.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1046, datë 23.10.2009

PËR LIRIM DHE EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 6 të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Arben Ivanaj, zëvendësministër i Shëndetësisë, lirohet nga kjo detyrë.
 2. Z. Bardh Spahia emërohet zëvendësministër i Shëndetësisë.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1047, datë 23.10.2009

PËR EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 6 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Nikollë Lesi emërohet zëvendësministër i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1048, datë 23.10.2009

PËR EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 6 të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Arben Demeti emërohet zëvendësministër i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 1049, datë 23.10.2009

PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË DETYRË TË PREFEKTIT TË QARKUT TË FIERIT

Në mbështetje të neneve 100 e 114 të Kushtetutës, dhe të nenit 4 të ligjit nr.8927, datë 25.7.2002 “Për prefektin”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Rauf Troka lirohet nga detyra e prefektit të qarkut të Fierit.
 2. Z. Bujar Hasaj emërohet prefekt i qarkut të Fierit.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1050, datë 23.10.2009

PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË DETYRË TË PREFEKTIT TË QARKUT TË DURRËSIT

Në mbështetje të neneve 100 e 114 të Kushtetutës, dhe të nenit 4 të ligjit nr.8927, datë 25.7.2002 “Për prefektin”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Klodian Pajuni lirohet nga detyra e prefektit të qarkut të Durrësit.
 2. Z. Genci Alizoti emërohet prefekt i qarkut të Durrësit.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 1059, datë 21.10.2009

PËR LEJIMIN E ZHVILLIMIT TË PROCEDURAVE TË DISA PROKURIMEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të nenit 9 të ligjit nr.10025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009” dhe të pikës 3 të vendimit nr.787, datë 22.7.2009 të Këshillit të Ministrave “Për një përdorim me efektivitet të fondeve për investime”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjetllës-Kanalizimeve, që, brenda datës 15 dhjetor 2009, të realizojë procedurat e prokurimit, për objektet e përcaktuara në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi (katër objekte). Brenda këtij afati të përfshihet edhe lidhja e kontratave përkatëse.
 2. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Tabela 1

Nr	Objekti i prokurimit	Autoriteti kontraktor
1	Ndërtimi i rrjetit të jashtëm të ujësjetllësit për zonat e plazhit Durrës-Kavajë nga pusshpimet e Rrogozhinës	Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetllës-Kanalizimeve
2	Ndërtimi i kolektorit kryesor të ujërave të zeza Sarandë, derdhja në IPUZ	Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetllës-Kanalizimeve
3	Ndërtimi i rrjetit të ujësjetllësit Përroi i Agait-Plepa, Durrës.	Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetllës-Kanalizimeve
4	Studim projektim për furnizimin me ujë të zonës së Dumresë, Elbasan.	Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetllës-Kanalizimeve

VENDIM
Nr.1061, datë 21.10.2009

PËR MIRATIMIN E FONDIT TË SHPENZIMEVE, PËR VITIN 2010, PËR ENTIN RREGULLATOR TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE TË LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 11 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e fondit të shpenzimeve, për vitin 2010, për Entin Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe të Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura, në shumën 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, sipas pasqyrës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

ENTI RREGULLATOR I UJIT

Pasqyra nr.1

PROJEKTPLANI I SHPENZIMEVE PËR VITIN 2010

Nr.	Emërtimi i shpenzimeve	Në lekë
1	Shpenzime për paga	18 241 000
2	Sigurime shoqërore	2 869 000
3	Shërbime e furnitura	5 300 000
4	Investime	3 590 000
	TOTALI	30 000 000

VENDIM
Nr. 1063, datë 21.10.2009

PËR DHËNIE, NDIHME FINANCIARE FAMILJEVE, TË TË NDJERËVE SHKËLZEN DESTAN DOBRUSHI DHE RAMADAN SADIK HILAJ, ISH- PUNONJËS POLICIE TË VRARË NË KRYE TË DETYRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6. 2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 12 të ligjit nr.10025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e një ndihme financiare, nga 3 000 000 (tre milionë) lekë, përkatësisht familjeve të të ndjerëve Shkëlzen Destan Dobrushit dhe Ramadan Sadik Hilaj, ish – punonjës policie në Drejtorinë e Policisë të qarkut Kukës, të vrarë në krye të detyrës.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.
 3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 1072, datë 21.10.2009

PËR LIRIM DHE EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 6 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Ekrem Spahiu, zëvendësministër i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve lirohet nga kjo detyrë.
 2. Z. Dashnor Bajaziti emërohet zëvendësministër i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1073, datë 21.10.2009

PËR LIRIM DHE EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 6 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Petrit Karabina, zëvendësministër i Mbrojtjes, lirohet nga kjo detyrë.
 2. Z. Arjan Starova emërohet zëvendësministër i Mbrojtjes.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1074, datë 21.10.2009

PËR EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 6 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

- Z. Ekrem Spahia emërohet zëvendësministër i Mbrojtjes.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1078, datë 28.10.2009

PËR LIRIM DHE EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 20 e 26 të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Ahmet Prençi, Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, lirohet nga kjo detyrë.
 2. Z. Hysni Burgaj emërohet Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1087, datë 28.10.2009

**PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMBËTAR TË VEPRIMIT PËR DEKADËN E PËRFSHIRJES
SË ROMËVE, 2010-2015**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e planit kombëtar të veprimit për dekadën e përfshirjes së romëve, 2010-2015, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1111, datë 13.11.2009

**PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDEVE BUXHETORE NGA KOMISIONI
QENDROR I ZGJEDHJEVE, PËR FINANCIMIN E SHPENZIMEVE PËR ZGJEDHJET E
PJESSHME PËR PUSHTETIN VENDOR, PËR DISA BASHKI E KOMUNA, MË 15 NËNTOR
2009**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr.10025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e përdorimit të një fondi prej 7 500 000 (shtatë milionë e pesëqind mijë) lekësh nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për financimin e zgjedhjeve të pjesshme për pushtetin vendor, që do të zhvillohen më 15 nëntor 2009, i cili të përdoret, si më poshtë vijon:

- 3 417 000 (tre milionë e katërqind e shtatëmbëdhjetë mijë) lekë, për paga e sigurime shoqërore e shëndetësore.

- 4 083 000 (katër milionë e tetëdhjetë e tre mijë) lekë, për mallra e shërbime.

2. Ky fond të përballohet nga buxheti i vitit 2009, miratuar për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

3. Ngarkohen Ministri i Financave dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1112, datë 13.11.2009

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.115, DATË 2.2.2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË
PËRKOHSHME, PËR VITIN 2009, NË DISA MINISTRI DHE INSTITUCIONE QENDRORE”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 18 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 1 e vendimit nr.115, datë 22.2.2009 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2009, për ministritë dhe institucionet qendrore, është 2 660 veta, sipas lidhjes nr.1 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

2. Ngarkohet Ministria e Financave të përcaktojë me hollësi numrin shtesë të punonjësve, sipas profesioneve dhe afateve kohore, në përputhje me lidhjen nr.1, e përmendur në pikën 1, të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data e hyrjes në fuqi të tij.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

Grupi	Emri i Institucionit	Nr. punonjësve
02	Kuvendi i Shqipërisë	11
03	Këshilli i Ministrave	1
04	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës	58
05	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit	213
06	Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit	815
10	Ministria e Financave	53
11	Ministria e Arsimit dhe Shkencës	113
12	Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	22
13	Ministria e Shëndetësisë	51
14	Ministria e Drejtësisë	31
15	Ministria e Punëve të Jashtme	16
16	Ministria e Brendshme	582
18	Shërbimi Informativ Shtetëror	40
20	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	30
25	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta	87
26	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave	140

28	Prokuroria e Përgjithshme	5
30	Gjykata Kushtetuese	2
31	Agjencia Telegrafike Shqiptare	4
50	INSTAT	378
63	Këshilli i Lartë i Drejtësisë	2
77	Autoriteti Konkurrencës	3
82	Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit	1
87	Institucione të tjera qeveritare	2
	TOTAL	2660

VENDIM
Nr.1118, datë 13.11.2009

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I LINJËS 220 KV, TEC I RI, VLORË-NËNSTACIONI 220/110/35 KV, BABICË, VLORË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.9561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i linjës 220 kv, Tec i Ri, Vlorë-nënstacioni 220/110/35kv, Babicë, Vlorë.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të KESH sh.a.-së.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në lekë, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompensimit, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 2 322,95 (dy mijë e treqind e njëzet e dy, presje nëntëdhjetë e pesë) m², tokë bujqësore, pyll, arë, ullishte vlerësuar me shumën 735 294 (shtatëqind e tridhjetë e pesë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e katër) lekë, dhe për produktin ulli, vlerësuar me shumën 192 000 (njëqind e nëntëdhjetë e dy mijë) lekë. Vlera e përgjithshme e shpronësimit është 927 294 (nëntëqind e njëzet e shtatë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e katër) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 927 294 (nëntëqind e njëzet e shtatë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e katër) lekë, të përballohet nga fondet e KESH sh.a.-së.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të shpronësimit, në shumën 333 000 (treqind e tridhjetë e tre mijë) lekë, të përballohet nga KESH sh.a.-ja.

6. Shpronësimi të fillojë në muajin nëntor dhe të përfundojë brenda vitit 2009.

7. Pagesa e pronarëve të përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të bëhet pas paraqitjes së dokumenteve të pronësisë, sipas ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”.

8. Punimet për ndërtimin e linjës 220 kv, Tec i Ri, Vlorë-nënstacioni 220/110/35kv, Babicë, Vlorë, të përfundojë brenda vitit 2009.

9. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe KESH sh.a.-ja, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1121, datë 13.11.2009

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2009, MIRATUAR PËR MINISTRINË E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE, PËR SHPËRBLIMIN E PESHËNGRITËSVE, ROMELA BEGAJ E ERKAND QERIMAJ, DHE TË TRAJNERËVE TË TYRE, HEKTOR SHAQIRI E ZEF KOVAÇI, PËR REZULTATET E LARTA, QË KANË ARRITUR NË LOJËRAT MESDHETARE, PESCARA 2009

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 12 të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në buxhetin e miratuar për vitin 2009, zëri “Projekte”, artikulli “604”, t’i shtohet fondi 2 600 000 (dy milionë e gjashtëqind mijë) lekë, për shpërblimin e peshëngritësve, Romela Begaj e Erkand Qerimaj, dhe të trajnerëve të tyre, Hektor Shaqiri e Zef Kovaçi, për rezultatet e larta të arritura në Lojërat Mesdhetare, Pescara 2009, zhvilluar në datat 26 qershor-5 korrik, në Itali, sipas preventivit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

3. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PREVENTIV

Në sportin e peshëngritjes në Lojërat Mesdhetare, zhvilluar në datat 26 qershor-5 korrik 2009 në Pescara Itali u arritën rezultatet e mëposhtme:

Peshëngritësja Romela Begaj, fituese e vendit të parë, Medalje Ari në shkëputje.

Shuma e shpërblimit prej 1 000 000 lekë.

Peshëngritësi Erkand Qerimaj, fitues i vendit të parë, Medalje Ari në shkëputje.

Shuma e shpërblimit prej 1 000 000 lekë.

Trajneri i sportistes Romela Begaj, z. Hektor Shaqiri

Shuma e shpërblimit prej 300 000 lekë.

Trajneri i sportistit Erkand Qerimaj, z. Zef Kovaçi

Shuma e shpërblimit prej 300 000 lekë.

Totali 2 600 000

VENDIM
Nr.1138, datë 18.11.2009

PËR MIRATIMIN E NJË FONDI SHITESË PËR KOMPENSIMIN E DËMEVE NË BANESAT E DËMTUARA NGA RRËSHQITJA MASIVE, NË LAGJEN QAFË-DARDHË TË FSHATIT GUR-SHPATË, KOMUNA POLIS, RRETHI LIBRAZH, QARKU ELBASAN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 12 të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, të ndryshuar, dhe të neneve 31 e 32, shkronja “a” të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komunës Polis të qarkut të Elbasanit, në buxhetin e vitit 2009, t'i shtohet fondi prej 18 626 851.5 (tetëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e njëzet e gjashtë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e një pikë pesë) lekësh, për t'ua shpërndarë familjeve, banesat e të cilave janë dëmtuar nga rrëshqitja masive në lagjen Qafë-Dardhë të Fshatit Gur-Shpatë, sipas listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Fondi prej 18 626 851.5 (tetëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e njëzet e gjashtë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e një pikë pesë) lekësh të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit, për vitin 2009.

3. Ngarkohet komuna Polis të kryejë pagesat për familjarët e përcaktuar në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kundrejt paraqitjes së dokumentacionit ligjor përkatës, duke u siguruar se banorët e rrezikuar, që përfitojnë kompensim, largohen nga banesat e mëparshme.

4. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Ministri i Financave, prefekti i qarkut të Elbasanit dhe kryetari i komunës Polis për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LISTA E KRYEFAMILJARËVE QË TRAJTOHEN ME NDIHMË

Nr.	Emri, Atësia, Mbiemri	Masa e ndihmës
1	Petrit Jonuz Poçi	829065.5
2	Luan Petrit Poçi	129366
3	Kujtim Jonuz Poçi	775860.5
4	Hamit Jonuz Poçi	509086.5
5	Hidajet Hamit Poçi	190381
6	Pëllumb Petrit Poçi	561032
7	Përparim Hamit Poçi	489077.5
8	Isuf Haziz Noni	1078568
9	Sami Osman Poçi	660487.5
10	Nexhip Veiz Noni	762656.5
11	Safet Haziz Tanushi	832753
12	Isuf Haziz Tanushi	748620
13	Gani Nuredin Stërmugu	632999.5
14	Xhevit Nuredin Stërmugu	853206.5
15	Mexhit Nuredin Stërmugu	841346.5
16	Qerim Qazim Stërmugu	1133546.5
17	Hamit Qazim Stërmugu	1084329
18	Nuredin Qazim Stërmugu	1053672
19	Qazim Nuredin Stërmugu	141068.5
20	Qamil Nuredin Stërmugu	145499.5
21	Kadri Selim Stërmugu	779188.5
22	Astrit Kadri Stërmugu	632999.5
23	Agim Jonuz Stërmugu	374500
24	Haqif Jonuz Stërmugu	644072.5
25	Hanë Miftar Stërmugu	730947.5
26	Selim Sabri Stërmugu	694794
27	Osman Faik Poçi	221365
28	Lahe Haziz Poçi	591177.5
29	Ramazan Osman Poçi	374393.5
30	Gazmir Ramazan Poçi	130791.5
	Shuma	18626851.5

Shënim: Lista mbyllet me numër rendor 30 (tridhjetë)

VENDIM
Nr.1139, datë 24.11.2009

**PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË AUTOMJETEVE DHE TË SHOFRËVE NË
DISPOZICION TË MINISTRIVE DHE TË INSTITUCIONEVE QENDRORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të ligjit nr.10 160, datë 15.10.2009 “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilë”, me propozimin e Ministrisë të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i përgjithshëm i automjeteve, në dispozicion të çdo ministrie dhe institucioni qendror, të jetë 3 138 (tre mijë e njëqind e tridhjetë e tetë), ndarë, si më poshtë vijon:

a) Numri i përgjithshëm i automjeteve të institucioneve të pavarura, 200 (dyqind), dhënë me hollësi në lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

b) Numri i përgjithshëm i automjeteve të ministrive dhe institucioneve në varësi të Këshillit të Ministrave, 2 938 (dy mijë e nëntëqind e tridhjetë e tetë) dhënë me hollësi në lidhjen nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Numri i përgjithshëm i shoferëve, në dispozicion të çdo ministrie dhe institucioni qendror, të jetë 1 258 (një mijë e dyqind e pesëdhjetë e tetë), ndarë, si më poshtë vijon:

a) Numri i përgjithshëm i shoferëve të institucioneve të pavarura, 148 (njëqind e dyzet e tetë) dhënë me hollësi në lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

b) Numri i përgjithshëm i shoferëve të ministrive dhe institucioneve, në varësi të Këshillit të Ministrave, 1 110 (një mijë e njëqind e dhjetë), dhënë me hollësi në lidhjen nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Në numrin e automjeteve dhe shoferëve sipas pikës 1/b dhe 2/b, për Ministrinë e Mbrojtjes përfshihen vetëm automjetet dhe shoferët e aparatit të institucionit.

4. Ngarkohen të gjitha ministrinë dhe institucionet, sipas pikës 1, të këtij vendimi, ta japin me hollësi numrin e automjeteve, për çdo institucion, në varësi të tyre.

5. Ngarkohen të gjitha ministrinë dhe institucionet, sipas pikës 1 të këtij vendimi për zbatimin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet e tij nga data 1 janar 2010.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

Gr.	Institucionet e pavarura	Nr. i automjeteve	Nr. i shoferëve
1	Presidenca	9	7
2	Kuvendi	15	10
24	Kontrolli i Lartë i Shtetit	9	5
28	Prokuroria e Përgjithshme	75	69
76	Inspektorati i Lartë i Kontrollit të Deklarimit të Pasurive	3	1
67	KSHC	1	1
66	Avokati i Popullit	7	3
30	Gjykata Kushtetuese	3	3
29	ZABGJ	59	39
55	Shkolla e Magjistraturës	1	1
73	KQZ	6	6
63	KLD	6	3
77	Autoriteti i Konkurrencës	2	0
86	Avokati i Prokurimeve	3	0
89	Komisioneri i Mbrojtjes së të Dhënave Personale	1	0
	TOTAL	200	148

Gr.	Emri i institucionit	Nr. i automjeteve	Nr. i shoferëve
3	Këshilli i Ministrave	15	7
4	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës	27	14
5	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit	33	20
6	Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit	44	42
10	Ministria e Financave	192	66
11	Ministria e Arsimit dhe Shkencës	78	50
12	Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	17	7
13	Ministria e Shëndetësisë	288	231
14	Ministria e Drejtësisë	86	86
15	Ministria e Punëve të Jashtme	13	7
16	Ministria e Brendshme	1,658	440
17	Ministria e Mbrojtjes	69	30
25	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta	41	20
26	Ministria e Mjedisit	45	19
78	Ministria e Integritit	3	2
20	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	7	1
18	Shërbimi Informativ Shtetëror	260	25
19	Drejtoria e Radio Televizionit	40	30
22	Akademia e Shkencave	1	1
31	Agjencia Telegrafike Shqiptare	6	4
50	Instituti i Statistikës	5	2
57	Qendra Kombëtare e Kinematografisë	1	0
59	Instituti i Integritit të Përndjekurve Politik	1	0
87	Agjencia e Prokurimit Publik	1	1
	Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar	1	0
	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit	1	0
	Komiteti i Minoriteteve	0	0
	Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare	5	5
	TOTAL	2 938	1 110

VENDIM
Nr.1140, datë 25.11.2009

PËR PROPOZIMIN KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË LIRIMIN NGA DETYRA TË ANËTARËVE TË KËSHILLIT DREJTUES TË ENTIT RREGULLATOR TË TELEKOMUNIKACIONEVE DHE EMËRIMIN NË DETYRË TË ANËTARËVE TË KËSHILLIT DREJTUES TË AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 114 të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008 “Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. T’i propozojë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë:
 - a) Lirimin nga detyra të anëtarëve të këshillit drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve:
 - Znj. Edlira Kasaj;
 - Z. Ilir Zela;
 - Z. Ilir Shehu;
 - Z.Afrim Tonuzi;
 - Z.Jetmir Karini.
 - b) Emërimin në detyrë të anëtarëve të këshillit drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare:
 - Z. Pirro Xhixho;
 - Znj. Alketa Mukavelati;

- Znj. Zamira Nurçe;
 - Z.Ibsen Elezi;
 - Z. Benon Paloka.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1152, datë 4.12.2009

PËR EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 6 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Visho Ajazi emërohet zëvendësministër i Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin..

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1204, datë 11.12.2009

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.659, DATË 3.10.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “ PËR RREGULLAT E KRYERJES SË PROCEDURAVE TË PROKURIMIT ME
MJETE ELEKTRONIKE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 22 e 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin, Këshilli i Ministrave

V ENDOSI:

Në fjalinë e parë të pikës 19 të kreut IV “ Dispozita të fundit”, në rregullat e kryerjes së procedurave të prokurimit me mjete elektronike, të miratuara me vendimin nr.659, datë 3.10.2007 të Këshillit të Ministrave, emërtimi “...Agjencia e Prokurimit Publik...” zëvendësohet me “...Ministri i Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin...”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1213, datë 11.12.2009

PER LIRIMIN DHE EMERIMIN NË DETYRË TË KRYETARIT TË QENDRËS KOMBËTARE
TË KINEMATOGRAFISË

Në mbështetje të nenit 100, pika 2 të Kushtetutës, dhe të nenit 7 të ligjit nr.8096, datë 21.3.1996 “Për kinematografinë”, i ndryshuar, me propozimin të Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Xhevdet Ferri lirohet nga detyra e Kryetarit të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë.
 2. Z. Artan Minarolli emërohet në detyrën e Kryetarit të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr.1215, datë 16.12.2009

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.1151, DATË 25.11.2009
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN DHE PËRDORIMIN E FONDIT TË
VEÇANTË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pas pikës 6 të vendimit nr.1151, datë 25.11.2009 të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 6/1, me këtë përmbajtje:

“6/1. Përjashtimisht, për vitin 2009, fondi i veçantë i planifikuar të përdoret vetëm për shpërblimin, deri në 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë, për të gjithë punonjësit mbështetës, pozicionet e të cilëve nuk kërkojnë, detyrimisht, arsimin e lartë, dhe që paguhen sipas sistemeve me 10, 14 dhe 22 klasa, ndërsa, deri në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë, për të gjithë punonjësit e tjerë.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr.1225, datë 11.12.2009

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2009, MIRATUAR PËR MINISTRINË E
SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE TË KURIMIT TË
Z.FADIL MEHMETAJ, NË GJERMANI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 12 të ligjit nr.10025, datë 27.1.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2009, zëri “Shpenzime operative”, t’i shtohet fondi 5 000 000 (pesë milionë)lekë, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të kurimit të z.Fadil Mehmetaj, në Gjermani.
 2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.
 3. Pagesat të bëhen kundrejt paraqitjes së faturave origjinale të institucionit shëndetësor të kurimit.
 4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1228, datë 16.12.2009

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2009, MIRATUAR PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE TË KURIMIT TË Z.DEJVIS KORRECI, NË ITALI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr.10025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë në buxhetin e miratuar për vitin 2009, zëri “Shpenzime operative”, t’i shtohet fondi prej 2 000 000 (dy milionë) lekësh, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të kurimit të z.Dejvis Korreci, në Itali.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

3. PAGESA TË BËHET ME PARAQITJEN E FATURAVE ORIGJINALE TË INSTITUCIONIT TË KURIMIT.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1229, datë 16.12.2009

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2009, MIRATUAR PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE TË KURIMIT TË ZNJ.NURIE MALOKU, NË TURQI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.10025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë në buxhetin e miratuar për vitin 2009, zëri “Shpenzime operative”, t’i shtohet fondi prej 3 000 000 (tre milionë) lekësh, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të kurimit të znj.Nurie Maloku, në Turqi.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

3. Pjesa e mbetur, prej 2 000 000 (dy milionë) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2009, zëri “Shpenzime operative”, dhënë Spitalit Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”.

4. PAGESA TË BËHET ME PARAQITJEN E FATURAVE ORIGJINALE TË INSTITUCIONIT TË KURIMIT.

5. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1244, datë 21.12.2009

PËR LIRIM DHE EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 6 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Znj. Zamira Sinoimeri, zëvendësministre e Shëndetësisë, lirohet nga kjo detyrë.
 2. Z. Albert Gajo emërohet zëvendësministër i Shëndetësisë.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1247, datë 24.12.2009


PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI INSTITUTIT TË STATISTIKAVE
(INSTAT) TË DISA MJEDISEVE, NË ADMINISTRIM TË MINISTRISË SË EKONOMISË,
TREGTISË DHE ENERGJETIKËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr.8743, datë 23.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës tek Instituti i Statistikave, të disa mjediseve, garazhe dhe kati i pestë, në ndërtesën 5-katëshe, të ish Ministrisë së Tregtisë së Jashtme, sipas planimetrive, që i bashkëlidhen këtij vendimi.
 2. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Instituti i Statistikave dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



VENDIM
Nr.1249, datë 16.12.2009

PËR ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN, PËRBËRJEN DHE PËRCAKTIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË KOMITETIT NDËRSEKTORIAL PËR MBROJTJEN E SHËNDETIT NGA PRODUKTET E DUHANIT (KNMSHPD)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17 të ligjit nr.9636, datë 6.11.2006 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komiteti Ndërsektorial për Mbrojtjen e Shëndetit nga Produktet e Duhanit (KNMSHPD) kryesohet nga ministri i Shëndetësisë dhe në përbërje ka këta anëtarë:

- Zëvendësministrin e Financave;
- Zëvendësministrin e Brendshëm ;
- Zëvendësministrin e Mbrojtjes;
- Zëvendësministrin e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve;
- Kryetarin e Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit;
- Drejtorin e Policisë së Shtetit ;
- Drejtorin e Përgjithshëm të Tatimeve;
- Kryetarin e Shoqatës së Bashkive.

2. KNMSHPD-ja ka për detyrë:

- të orientojë politikat dhe strategjitë për mbrojtjen e shëndetit të publikut nga produktet e duhanit ;
- të propozojë rishikimin e akteve, ligjore dhe nënligjore, në fuqi për mbrojtjen e shëndetit të publikut nga produktet e duhanit;
- të propozojë programe dhe projekte për të siguruar uljen e përdorimit të produkteve të duhanit dhe mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve, si dhe t'i monitorojë e vlerësojë ato;
- të angazhohet për orientimin e burimeve dhe të projekteve, që synojnë uljen e përdorimit të produkteve të duhanit dhe mbrojtjen e shëndetit prej tyre;
- të përcaktojë formën dhe tekstin e mesazheve në çdo njësi pakete apo paketimi të produkteve të duhanit, të cilat i përditëson të paktën çdo dy vjet;
- të sigurojë një bashkëpunim me institucionet qeveritare dhe joqeveritare brenda dhe jashtë vendit për politikat e kontrollit të duhanit;
- të raportojë, nëpërmjet kryetarit, çdo vit, te komisioni parlamentar përkatës.

3. KNMSHPD-ja mbledhet jo më pak se 4 herë në vit dhe thirret nga kryetari, i cili, 5 ditë para mbledhjes, u njofton anëtarëve rendin e ditës dhe u dërgon atyre materialet përkatëse.

4. Mbledhjet janë të vlefshme, kur marrin pjesë jo më pak se gjysma e anëtarëve dhe vendimet merren me shumicë votash. Në rast barazimi të votave “pro” dhe “kundër”, vota e kryetarit është përcaktuese.

5. Pranë Institutit të Shëndetit Publik, ngrihet sekretariati teknik i këtij komiteti për mbështetjen teknike të tij. Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të tij përcaktohet me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë.

6. Masa e shpërblimit të anëtarëve për çdo mbledhje është 5 000 (pesë mijë) lekë.

7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë.

8. Vendimi nr.113, datë 17.2.2007 i Këshillit të Ministrave “Për organizimin, funksionimin, përbërjen dhe përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të Komitetit Ndërsektorial për Mbrojtjen e Shëndetit nga Produktet e Duhanit (KNMSHPD)”, shfuqizohet.

9. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1251, datë 29.12.2009

PËR LEJIMIN E BOTIMIT TË KONTRATËS SË NËNSHKRUAR NGA DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE, SI AUTORITET KONTRAKTOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Lejimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, si autoritet kontraktor, të shpallë, brenda datës 31.12.2009, në Buletinin e Njoftimeve Publike, njoftimin e kontratës së nënshkruar për tenderin, me objekt “Hartimi i projekteve të zbatimit dhe preventivat përfundimtarë të rikonstruksionit, të mjediseve të shërbimit tatimpagues, në drejtoritë rajonale tatimore Tiranë e Durrës”.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1252, datë 7.12.2009

PËR EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 6 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Avenir Peka emërohet zëvendësministër i Brendshëm.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1257, datë 23.12.2009

PËR NJË SHITESË FONDI BASHKISË BERAT, PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE FAMILJES SË SHTETASIT ARTUR KAJA, SI PASOJË E ZJARRIT TË RËNË NË BANESË, MË 22.11.2009

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 12 të ligjit nr.10025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, të ndryshuar, dhe të neneve 31 e 32, shkronja “a” të ligjit nr. 8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Bashkisë Berat, në buxhetin e miratuar për vitin 2009, t’i shtohet fondi prej 1 900 000 (një milion e nëntëqind mijë) lekësh, për t’iu dhënë si ndihmë financiare familjes së shtetasit Artur Kaja, së cilës iu shkaktuan dy viktima dhe tre të plagosur rëndë nga zjarri i rënë në banesë, më 22.11.2009, si më poshtë vijon:

a) Për dy viktimat Megi dhe Kelina Kaja, ndihma financiare të jetë 1 000 000 (një milion) lekë, e ndarë nga 500 000 (pesëqind mijë) lekë, për çdo viktimë.

b) Për tre të plagosurit rëndë, Hylson, Mimoza e Artur Kaja, ndihma financiare të jetë 900 000 (nëntëqind mijë) lekë, e ndarë nga 300 000 (treqind mijë) lekë, për person.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

3. Ngarkohen Ministri i Financave, Ministri i Brendshëm, prefekti i qarkut Berat dhe bashkia Berat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr.1262, datë 29.12.2009

PËR EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 6 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Selim Belortaja emërohet zëvendësministër i Punëve të Jashtme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr.1276, datë 23.12.2009

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 824, DATË 6.12.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E INSTITUCIONEVE TË AUTORIZUARA PËR VERIFIKIMIN, NË MËNYRË ELEKTRONIKE, TË GJENDJES GJYQËSORE, SI DHE TË FORMULARIT TË VETËDEKLARIMIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 7, 8 e 11 të ligjit nr.9614, datë 21.9.2006 "Për certifikatat elektronike të gjendjes gjyqësore", me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.824, datë 6.12.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa:

1. Pas pikës 25 të pikës I, të shtohen pikat 26 deri 38, me këtë përmbajtje:

"26. Ministria e Arsimit dhe Shkencës;

27. Gjykata Kushtetuese;

28. Enti Rregullator i Energjisë;

29. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare;

30. Ministria e Mbrojtjes për Autoritetin e Kontrollit Shtetëror të Eksporteve dhe Shërbimin Informativ Ushtarak;

31. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, për Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe drejtorinë rajonale të punësimit, Tiranë;

32. Ministria e Shëndetësisë, për Drejtorinë e Shëndetit Publik, Pogradec;

33. Ministria e Financave, për Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Institutin e Sigurimeve Shoqërore;

34. Këshilli i Ministrave, për Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar;

35. Ministria e Brendshme, për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm;

36. Ministria e Punëve të Jashtme, për shërbimet diplomatike;
37. Kontrolli i Lartë i Shtetit;
38. Bashkia Korçë.”.

2. Pas pikës I, shtohet pika I/1, më këtë përmbajtje:

“I/1.Institucionet e autorizuara, gjatë verifikimit elektronik të gjendjes gjyqësore, marrin masat për respektimin e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1288, datë 23.12.2009

**PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË AUTORITETIT
KOMBËTAR TË USHQIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 65, të ligjit nr.9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Genc Juka emërohet në detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr.3, datë 19.11.2009

**PËR METODOLOGJINË E VLERËSIMIT TË
RAPORTIT TË VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës dhe në zbatim të germës “ç” të nenit 66 të ligjit nr.8934, datë 5. 9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Në vlerësimin e raporteve të VNM-së të zbatohen kërkesat e metodologjisë “Për vlerësimin e raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis”, si dhe të shtojcave bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2. Metodologjia orienton:

- a) agjencitë rajonale të mjedisit (ARM-të);
- b) drejtoritë e MMPAU-së; si dhe
- c) aktorët e përfshirë në procesin e vlerësimit të ndikimit në mjedis.

3. Metodologjia e vlerësimit të raportit të VNM-së ka për qëllim:

a) vlerësimin e raportit të VNM-së të një veprimtarie a projekti të propozuar, nëse është hartuar në përputhje me kërkesat e legjislacionit përkatës mjedisor, sipas detajimeve specifike në shtojcën III të këtij udhëzimi;

b) vlerëson nëse informacioni mjedisor është i plotë, i besueshëm dhe i mjaftueshëm ose jo për vendimmarrjen.

4. Drejtoria e VNM-së dhe lejeve dhe ARM-të, në funksion të procedurave të vlerësimit të ndikimit në mjedis, bëjnë vlerësimin e raportit duke ndjekur hapat e mposhtëm:

- a) Shqyrtohet paraprakisht raporti për të kuptuar strukturën e ndërtimit të tij.

b) Përdoret shtojca I, ku do të përcaktohen dhe vlerësohen se cila prej kërkesave të saj lidhen specifikisht me projektin dhe sa informacion është dhënë për to në raport.

Duhet të mbahet parasysh se në varësi të projektit, jo të gjitha kërkesat e pyetësorit kërkojnë përgjigje, pasi mund të mos i përgjigjen projektit konkret të propozuar, p.sh. nëse projekti nuk ka çlirim të ndotësve në mjedis, atëherë kjo kërkesë e pyetësorit nuk kërkon përgjigje.

c) Nëse informacioni vlerësohet i pamjaftueshëm, në kolonën e fundit të shtojcës I shënohet se çfarë informacioni shtesë do t'i kërkohej propozuesit. Për shmangien e vonesave në plotësim mbahen parasysh këta faktorë: kërkesat ligjore mjedisore për projektin; "faza e projektit"; ndjeshmëria mjedisore e zonës dhe kompleksiteti i projektit; si dhe pikëpamjet e publikut dhe të aktorëve të konsultuar për projektin.

d) Pasi të jenë ezauruar kërkesat e germës "b"/4 të këtij udhëzimi, plotësohen kërkesat e pyetësorit të shtojca II. Informacioni duhet të jetë i qartë, i plotë dhe i mjaftueshëm për të bërë të mundur kuptimin e projektit dhe për të ndihmuar në vendimmarrjen përfundimtare për të.

5. Pasi plotësohet pyetësori në shtojcën II, bëhet vlerësimi përfundimtar i cilësisë së raportit, sipas shtojcës III bashkëlidhur, duke identifikuar çështjet që duhet të trajtohen më tej, si dhe çfarë informacioni mungon dhe që duhet të plotësohet nga propozuesi.

6. Vlerësimi i cilësisë e raportit bazohet mbi përgjigjet e dhëna nga kërkesat e mëposhtme.

a) Nëse dokumenti i VNM-së përmban pasqyrë lënde dhe tregues për informacionin që përmban;

b) Nëse materiali është i strukturuar në mënyrë logjike (p.sh. përshkrimi i mjedisit, parashikimi i ndikimeve, rëndësia/signifikanca e ndikimeve negative, masat zbutëse dhe angazhimet për zbatimin e tyre etj.);

c) Nëse ka një përshkrim të qartë të procedurës së vendimmarrjes dhe përputhshmërisë së VNM-së me kërkesat e legjislacionit përkatës;

d) Nëse informacioni përmban referenca ndihmuese/shpjeguese (p.sh. shkarkimet në ajër etj.);

e) Nëse materiali është i fokusuar vetëm në çështje me rëndësi, shmang teorinë dhe informacionin e papërshtatshëm dhe të panevojshëm, është objektiv;

f) Është shkruar i qartë dhe në mënyrë të paanshme;

g) Përmban një përshkrim të plotë të qëllimit dhe veprimtarisë/projektit;

h) Ilustron informacionin/të dhënat me diagrama, skica, tabela, grafikë, fotografi që ndihmojnë në të kuptuarit e tekstit përkatës;

i) Përdor terminologji të njëjtë, si dhe jep përkufizimet e saj;

j) Përmban referencat e të dhënave dhe informacionit që ka përdorur;

k) Bën shpjegime për të qartësuar çështjet komplekse;

l) Përshkruan qartë metodikat e përdorura për realizimin e VNM-së dhe hartimin e raportit;

m) Bën një përshkrim të mirë të çështjeve në raport edhe me rëndësinë e secilës;

n) Përmban evidenca të konsultimeve;

o) Përmban analizim dhe diskutim të alternativave;

p) Përmban një program masash zbutëse dhe monitoruese dhe përcakton përgjegjësitë për zbatimin e secilës;

q) Përmban një përmbledhje joteknike, të kuptueshme për lexuesin dhe publikun.

7. Në përfundim të vlerësimit, konkludohet nëse:

a) raporti i VNM-së vlerësohet i plotë, zbatohen më tej kërkesat e ligjit të vlerësimit të ndikimit në mjedis;

b) raporti i VNM-së vlerësohet me mangësi në informacion, bëhen komunikimet me propozuesin sipas kërkesave të ligjit të vlerësimit të ndikimit në mjedis;

8. Shtojcat e këtij udhëzimi, pasi plotësohen, bëhen pjesë e dokumentacionit të dosjes dhe arkivohen së bashku me dokumentet e tjera të miratimit të ushtrimit të veprimtarisë apo projektit të propozuar.

9. Ngarkohen Drejtorja e VNM-së dhe Lejeve dhe agjencitë rajonale të mjedisit për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MJEDISIT,
PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Fatmir Mediu

PËRMBAJTJA

A. Shtojca I “Pyetësi i vlerësimit/verifikimit” është organizuar në formën e një pyetësi të ndarë në 7 seksione, ku janë detajuar kërkesat standarde që duhet të përmbajë hartimi i raportit të VNM-së, bazuar në kërkesat e legjislacionit mjedisor dhe konkretisht të neneve 8 dhe 9 të ligjit nr 8990, datë 23.1.2003 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”.

1. Në orientimin vertikal të pyetësorit detajohen një sërë pyetjesh, që synojnë të vlerësojnë nëse raporti i trajton çështjet e duhura mjedisore dhe nëse e përmban informacionin e duhur:

1. për përshkrimin e projektit;
2. për konsiderimin e alternativave;
3. për përshkrimin e vlerave natyrore dhe parametrave mjedisorë që mund të ndikohen nga projekti;

4. për përshkrim për ndikimet negative të rëndësishme në mjedis të projektit;

5. për përshkrimin e masave për zbutjen e ndikimeve negative;

6. për përmbledhje joteknike të raportit.

2. Në orientimin horizontal të pyetësorit detajohen tri kolona, ku bëhen shënimet:

- Shënohet JO nëse informacioni mungon;

- Shënohet PO nëse është trajtuar me informacion mjaftueshëm; dhe

- Nëse ka nevojë për informacion shtesë, bëhen shënimet në kolonën e fundit.

B. Shtojca II përmban informacionin mjedisor që duhet të përmbajë dhe të trajtohet në raportin e VNM-së, sipas kërkesave të direktivës 97/11/EC “Mbi vlerësimin e ndikimeve që shkaktohen nga aktivitetet private dhe publike në mjedis”(neni5/1).

C. Shtojca III përmban mënyrën sesi realizohet vlerësimi përfundimtar i raportit të VNM-së.

SHTOJCA I
PYETËSORI I VLERËSIMIT/VERIFIKIMIT

SEKSIONI 1 – PËRSHKRIMI I PROJEKTIT				
	Pyetja vlerësuese	PO	JO	Çfarë informacioni (shitesë apo që mungon) nevojitet?
Objektivat dhe karakteristikat fizike të projektit				
1.1	Përshkruhet qëllimi dhe objektivat e projektit?			
1.2	A përshkruhet programi i ndërtimit të objekteve dhe pajisjeve të veprimtarisë, afatet kohore, koha e funksionimit dhe e mbylljes? (Këtu duhet të përfshihet çdo fazë e aktiviteteve të ndryshme brenda veprimtarisë p.sh. nxjerrja e mineralit etj.)			
1.3	A përshkruhen komponentët kryesorë të veprimtarisë, si pajisje, objektet etj?			
1.4	A përshkruhet vendi ku do të ndërtohet apo instalohet çdo komponent i veprimtarisë duke përdorur harta, diagrami apo planvendosje sipas rastit? (përfshi ndërtesa, struktura fizike, punime nëntoke, depo dhe magazina, zona të gjelbërta, rrugët e aksesit dhe kufijtë e secilës dhe të vetë sipërfaqes së përgjithshme)?			
1.5	A jepet planvendosja e plotë e projektit, veprimtarisë dhe sipërfaqja që do të zihet nga veprimtaria?			
1.6	A përshkruhen rrugët e aksesit dhe të lëvizjes vertikale dhe horizontale apo tunele dhe punime në tokë (civile)?			
1.7	A përshkruhen të gjitha aktivitetet dhe operacionet ndërtimore në kuadër të veprimtarisë ?			
1.8	A përshkruhen të gjitha aktivitetet në fazën e funksionimit/operimit të veprimtarisë?			
1.9	A përshkruhen të gjitha aktivitetet dhe operacionet e mbylljes dhe çmontimit të pajisjeve të veprimtarisë? (Dëmtimi, pastrimi i sipërfaqes, rehabilitimi dhe mbjellja etj.)			
1.10	A përshkruhen shërbime shtesë të nevojshme për projektin, si transport, ndërtimi i rrugëve të reja, ujë, shkarkimi i ujërave të zeza, hedhja e mbetjeve, ndërtimi i linjave të elektricitetit, tubacione, linja komunikim, porte etj.?			
1.11	A identifikohet mundësia e zhvillimeve të tjera si pasojë e veprimtarisë? (si p.sh. banesa, rrugë, nxjerrje të lëndëve të para) etj.?			
1.12	A janë identifikuar dhe a jepet informacion nëse aktivitetet ekzistuese mund të ndikohen nga veprimtaria?			
1.13	A janë identifikuar aktivitetet ekzistuese apo të planifikuara me të cilat mund të ndërveprojë veprimtaria dhe të shfaqen ndikime kumulative shumatore e ndikimeve të secilës apo ndërveprim?			
1.14	A jepen të dhëna për sipërfaqen e tokës që do të zihet nga strukturat/godinat e përhershme të veprimtarisë, e shoqëruar me hartë me shkallë?			
1.15	A jepen të dhëna për sipërfaqen e tokës që do të zihet nga strukturat/godinat e përkohshme të veprimtarisë, e shoqëruar me hartë me shkallë?			
1.16	Aktualisht a është vendosur apo po bëhen punime paraprake përkohësisht në vendin e projektit për të cilën është përgatitur raporti i VNM-së (p.sh. përdorimi i tokës për aktivitete minerare)?			
1.17	A jepen të dhëna për përmasat fizike të strukturave dhe objekteve të veprimtarisë? (sipërfaqe, lartësia, arkitektura, llojet e bimësisë që do mbillen, volume të punëve në tokë, ura, oxhakë shpime për marrjen e ujit)			

1.18	A jepen të dhëna/përshkruhet për arkitekturën e strukturave dhe objekteve të veprimtarisë? (p.sh. disenjimi i jashtëm i godinave, ngjyra, ngjyrat, format e peizazhit të mbjelljeve të planifikuara etj.)			
1.19	Nëse veprimtaria zhvillohet në zonë urbane apo të ngjashme me të, a jepen të dhëna për numrin dhe karakteristikat e popullsisë dhe shpërndarja e tyre në raport me vendin ku do të ushtrohet veprimtaria?			
1.20	Nëse për qëllimin e veprimtarisë duhet të zhvendosen banorë apo biznese, a përshkruhen dhe jepen të dhëna për numrin dhe karakteristikat e tyre?			
1.21	Nëse veprimtaria parashikon ndërtimin e infrastrukturës së re për transport apo nëse veprimtaria do të sjellë shtim të konsiderueshëm të trafikut, a jepen të dhëna për fluksin e mjeteve, volumin dhe shpërndarjen e këtij trafiku?			
1.22	A përshkruhen të gjitha proceset e fazës së funksionimit dhe të operimit të veprimtarisë? (p.sh. procese inxhinierike, prodhim/nxjerrja e lëndëve të para, praktika pyjore apo bujqësore të prodhimit të lëndëve të para etj.)?			
1.23	A përshkruhen apo jepen të dhëna për llojin dhe volumin e produkteve finale të veprimtarisë? (produkte finale, shërbimet apo mallra etj., lëndë të përdorshme si mbetje apo skarcitet?			
1.24	A përshkruhen apo jepen të dhëna për llojin dhe sasinë e lëndëve dhe energjisë të nevojshme për ndërtimin dhe funksionimin e veprimtarisë?			
1.25	A paraqiten/përshkruhen ndikimet në mjedis për furnizimin me lëndë të para apo si pasojë e nxjerrjes së lëndëve të para (ndikimet në nxjerrjen e mineraleve)?			
1.26	A përshkruhen masat apo eficienta në përdorimin e energjisë dhe lëndëve të para?			
1.27	A përshkruhen dhe jepen të dhëna për llojin dhe sasinë e substancave të rrezikshme që do të përdoren, depozitohen apo prodhohen nga veprimtaria gjatë: - fazës së ndërtimit, - fazës së funksionimit, - fazës së mbylljes, çmontimit?			
1.28	A përshkruhen dhe jepen të dhëna për transportin e lëndëve të para dhe volumin e trafikut, lëvizja, mënyrat e transportit gjatë: - fazës së ndërtimit, - fazës së funksionimit, - fazës së mbylljes, çmontimit?			
1.29	A përshkruhet/trajtohet punësimi ose humbja e vendeve të punës si pasojë e veprimtarisë gjatë: - fazës së ndërtimit, - fazës së funksionimit, - fazës së mbylljes, çmontimit?			
1.30	A janë vlerësuar rregullimet dhe volumi i trafikut për transportin e punëtorëve në vendin ku do të ushtrohet veprimtaria gjatë: - fazës së ndërtimit, - fazës së funksionimit, - fazës së mbylljes, çmontimit?			
1.32	A përshkruhen/diskutohen nevoja për objekte të përkohshme apo përhershme për strehimin e punonjësve (p.sh. ndërtimi i kampeve dhe strukturave të shërbimeve etj.) ?			
1.33	A jepet informacion për llojin dhe sasinë e mbetjeve të ngurta që do të gjenerohen/prodhohen nga veprimtaria (duke përfshirë mbetjet e ndërtimit apo prishjes, mbetjet e rrezikshme, mbetje bujqësore, minerare etj.) gjatë: - fazës së ndërtimit, - fazës së funksionimit, - fazës së mbylljes, çmontimit?			

1.34	A përshkruhen/jepen të dhëna për përbërjen apo toksicitetin apo rrezikshmërinë e mbetjeve të ngurta që do të gjenerohen/prodhohen nga veprimtaria?			
1.35	A përshkruhen mënyrat për mbledhjen, ruajtjen dhe trajtimin apo transportin dhe depozitimin përfundimtar të mbetjeve të ngurta?			
1.36	A përshkruhet depozitimi përfundimtar i mbetjeve të ngurta?			
1.37	A përshkruhen lloji dhe sasia e mbetjeve/shkarkimeve të lëngëta që do të prodhohen nga veprimtaria si p.sh. ujërat e drenazhimit, ujëra teknologjike, ujëra të ndotura të zeza etj gjatë fazës së: - ndërtimit, - funksionimit, - mbylljes, çmontimit?			
1.38	A përshkruhen/jepen të dhëna për përbërjen apo toksicitetin, apo rrezikshmërinë e mbetjeve/shkarkimeve të lëngëta që do të gjenerohen/prodhohen nga veprimtaria?			
1.39	A përshkruhen mënyrat për mbledhjen, ruajtjen dhe trajtimin apo transportin dhe depozitimin përfundimtar të ujërave të ndotura/përdorura?			
1.40	A përshkruhet depozitimi përfundimtar i mbetjeve të lëngëta/ujërave të ndotura?			
1.41	A përshkruhet/jepen të dhëna për llojin dhe sasinë e shkarkimeve në ajër (gaze, pluhura) të veprimtarisë (shkarkime të proceseve, lëshimeve të pakontrolluara, të djegies së lëndëve fosile, të trafikut, pluhura nga materialet apo aroma) gjatë: - fazës së ndërtimit, - fazës së funksionimit, - fazës së mbylljes, çmontimit?			
1.42	A identifikohen dhe përshkruhen përbërja, vetitë e shkarkimeve në ajër të veprimtarisë?			
1.43	A përshkruhen metodat dhe masat për kapjen, trajtimin dhe shkarkimin përfundimtar në mjedis të shkarkimeve në ajër?			
1.44	A jepen të dhëna/përshkruhen pikat e shkarkimit në ajër të shkarkimeve të përshkruara (e.g. lartësia e oxhakut, volumi, shpejtësia dhe temperatura e shkarkimit etj.)?			
1.45	A jepet informacion për mundësinë e ripërdorimit/riciklimit të mbetjeve dhe ujërave të ndotura (p.sh. ripërdorimi, riciklimi, ripërdorimi për qëllime energjetike)?			
1.46	A janë identifikuar dhe vlerësuar burimet e mundshme të zhurmës, nxehtësisë, ndriçimit apo rrezatimit elektromagnetik, si p.sh. nga pajisjet, proceset, ndriçimi, trafik, punët ndërtimore etj.?			
1.47	A përshkruhen metodat e përdorura për vlerësimin e cilësisë dhe sasisë së shkarkimeve, si dhe vështrësitë metodike nëse?			
1.48	A diskutohet pasiguria apo mospërputhshmëria e vlerësimit të shkarkimeve dhe mbetjeve si pasojë e mungesës në të dhëna dhe njohuri ?			
Rreziku nga aksidentet				
1.49	A flitet në raport për ndonjë rrezikshmëri që paraqet veprimtaria? - si pasojë e përdorimit të substancave të rrezikshme; - si pasojë e derdhjeve, zjarrit apo eksplozimit; - rreziqet e trafikut; - rreziqe si pasojë e avarive të pajisjeve apo gjatë proceseve; - rrezik si pasojë e ekspozimit të projektit ndaj fenomeneve natyrore si përmbytja, tërmete, rrëshqitje toke etj.			
1.50	A përshkruhen masat që do të ndërmerren për parandalimin dhe veprimin ndaj aksidenteve të përshkruara sipas pikës 1.49? (masa parandaluese, trajnime, plan emergjence etj.)			
Pyetje të tjera lidhur me veprimtarinë/projektin				

SEKSIONI 2 – KONSIDERIMI I ALTERNATIVAVE

	Pyetja vlerësuese	PO	JO	Çfarë informacioni (shtesë apo që mungon) nevojitet?
2.1	A përshkruhet procesi i përzgjedhjes së projektit, si dhe a janë analizuar alternativat gjatë hartimit të projektit/veprimtarisë?			
2.2	A analizohet skenari bazë apo skenari “pa projekt” nëse nuk do të zhvillohej veprimtaria?			
2.3	A trajtohen në nivel të përshtatshëm skenarët apo alternativat e projektit?			
2.4	A shpjegohen arsyet kryesore të përzgjedhjes së alternativës së paraqitur të veprimtarisë, përfshi edhe kriteret apo konsideratat mjedisore?			
2.5	A janë krahasuar ndikimet kryesore në mjedis të secilës alternativë?			

Pyetje të tjera lidhur me veprimtarinë/projektin

--	--	--	--	--

SEKSIONI 3 - PËRSHKRIMI I KARAKTERISTIKAVE TË MJEDISIT QË MUND TË NDIKOHET

	Pyetja vlerësuese	PO	JO	Çfarë informacioni shtesë apo që mungon nevojitet?
Veçoritë e mjedisit				
3.1	A përshkruhet në mënyrë të saktë vendndodhja e zonës ku ushtrohet veprimtaria dhe rrethinat e saj, përfshi edhe banesat përreth? (përfshi qendra të banuara, aktivitete industriale, bujqësore, pushimi etj.)			
3.2	A jepen të dhëna/përshkruhet përdorimi ekzistues i sipërfaqes së tokës ku do të ushtrohet veprimtaria (përdorimi i tokës, cilësitë bujqësore etj.) ?			
3.3	A përshkruhen gjeologjia, topografia dhe tipi i tokës, përfshi edhe fenomenet natyrore të pranishme (nëse) në sipërfaqen e vendosjes së projektit si erozioni etj.?			
3.4	A jepen informacion për florën dhe faunën, si dhe habitatet e sipërfaqes dhe zonës përreth vendndodhjes së projektit, si dhe ilustrimet grafike si hartë vegjetacioni, imazhe nga sipërfaqja që do të duhet të zihet nga veprimtaria?			
3.5	A jepen informacion mbi llojet bimore dhe shtazore që mund të ndikohen nga projekti si popullatën, cilësitë e habitatit, statusin e tyre të mbrojtjes? (sipas VKM nr.804, datë 4.12. 2003 “Për miratimin e listës së specieve të florës shqiptare, që vihen në mbrojtje”, apo urdhri i ministrit nr.146, datë 8.5.2007 “Për miratimin e listës së kuqe të florës dhe faunës” dhe monumentet e natyrës VKM nr.676, datë 20.12.2002 “Për shpalljen zonë e mbrojtur të monumenteve të natyrës shqiptare” apo legjislacionit të zonave të mbrojtura etj.			
3.6	A jepen informacion/përshkruhen trupat ujorë/mjediset ujore të zonës ku do të ushtrohet veprimtaria (përfshi të dhëna statistikore, ujërat nëntokësore, bregdetare etj.)?			
3.7	A jepen informacion/përshkruhet cilësia e ujërave dhe përdorimi i tyre në zonën e projektit dhe që mund të ndikohen nga projekti/veprimtaria (si përdorimi familjar, peshkim, plazh, lundrim, shkarkime ujërash etj.)?			
3.8	A përshkruhen vlerat klimaterike dhe meteorologjike të zonës (vetëm ato) të cilat mund të ndikohen nga projekti?			

3.9	A përshkruhet/jepen të dhëna për cilësinë e ajrit të zonës së projektit, si dhe vlerat e zhurmave (vetëm nëse do të mund të ndikohen nga projekti)?			
3.10	A jepet informacion për rrezatimet elektromagnetike, ndriçimin etj. në zonën e projektit/veprimtarisë (vetëm nëse do të mund të ndikohen nga projekti) ?			
3.11	A jepet informacion për burimet natyrore dhe asetet të tjera që do të përdoren apo ndikohen nga veprimtaria (si objektet, struktura të tjera burime minerale dhe ujore etj.)?			
3.12	A jepet informacion për vlerat kulturore të zonës në afërsi të sipërfaqes së projektit (arkeologji, monumente, vepra arti, infrastrukturë ujëtare, rrugore etj.)?			
3.13	A përshkruhen vlerat e peizazhit të zonës së projektit që mund të ndikoheshin nga projekti?			
3.14	A jepet informacion për qendrat e banuara, popullsinë, dhe aktivitetet ekonomike të zonës së projektit, si p.sh. punësimi etj.?			
3.15	A jepet informacion nëse ndonjë nga komponentët e trajtuar më sipër (mjedis, popullsi, kulturë etj.) mund të pësojë ndryshime nëse nuk zhvillohet veprimtaria?(skenari pa projekt)			
3.16	Studimi në kuadër të hartimit të VNM-së apo projektit, a është i shtrirë mjaftueshëm sa të përfshijë të gjithë sipërfaqen/zonën, receptorët që mund të ndikohet në mënyrë domethënëse nga veprimtaria?			
3.17	A janë kontaktuar të gjitha organet shtetërore e duhura lokale apo kombëtare për të mbledhur të dhënat për projektin?			
3.18	A jepen referencat/burimet e të dhënave ekzistuese të mjedisit që janë përdorur në raportin e VNM-së?			
3.19	A janë realizuar vërtetime në terren si pjesë e hartimit të raportit të VNM-së për të përshkruar veçoritë e mjedisit ekzistues, ç'farë metodika vërtetimi janë përdorur dhe a janë hasur vështirësi apo pasaktësi të të dhënave ekzistuese apo ato të mbledhura gjatë vërtetimit në terren?			
3.20	A vlerësohen të përshtatshme metodat e zbatuara në kuadër të hartimit të raportit të VNM-së?			
3.21	Në rast të mungesës së të dhënave për mjedisin, a identifikohen mangësitë në të dhëna dhe informacion, mënyrat për t'u siguruar këto të dhëna gjatë në kuadër të VNM-së?			
3.22	Në rast se nevojiten vërtetime në terren që të përshkruhen plotësisht veçoritë e mjedisit, por këto vërtetime nuk janë realizuar për ndonjë arsye, a shpjegohet arsyeja pse nuk janë realizuar dhe a janë planifikuar të realizohen në një fazë në mëvonshme?			

Pyetje të tjera lidhur me veprimtarinë/projektin

SEKSIONI 4 - PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE TË RËNDËSISHME TË VEPRIMTARISË

	Pyetja vlerësuese	PO	JO	Çfarë informacioni shtesë apo që mungon nevojitet?
Identifikimi i ndikimeve të veprimtarisë				
4.1	A përshkruhet procesi i përcaktimit të çështjeve e do të trajtohen në raportin/gjatë vlerësimit të ndikimit në mjedis? (udhëzimit nr.6, datë 27.12.2006 "Për miratimin e metodologjisë së vlerësimit paraprak të ndikimeve në mjedis të një veprimtarie")			
4.2	A pasqyrohet metodika e identifikimit të ndikimeve të veprimtarisë?			
4.3	A pasqyrohet/dokumentohet procesi i konsultimit gjatë fazës së përcaktimit/identifikimit të ndikimeve ?			
4.4	A janë pasqyruar/paraqitur komentet dhe opinionet e të konsultuarve?			

Parashikimi i ndikimeve direkte

4.5	A janë përshkruar dhe kur nevojitet vlerësuar/matur ndikimet direkte në përdorimin e tokës, njerëz, dhe pronat në zonën e ndikimit të veprimtarisë?			
4.6	A janë përshkruar dhe kur nevojitet vlerësuar/matur ndikimet direkte për cilësitë gjeologjike të tokës në zonën e ndikimit të veprimtarisë?			
4.7	A janë përshkruar dhe kur nevojitet vlerësuar/përlogaritur ndikimet direkte të veprimtarisë në faunë, florë dhe habitatet e zonës?			
4.8	A janë përshkruar dhe kur nevojitet vlerësuar/matur ndikimet direkte të veprimtarisë në burimet ujore, hidrologji dhe cilësinë e ujërave në zonë (zonën e ndikimit)?			
4.9	A janë përshkruar dhe kur nevojitet vlerësuar/matur ndikimet direkte në përdorimin e burimeve ujore të zonës?			
4.10	A janë përshkruar dhe kur nevojitet vlerësuar/matur ndikimet direkte në kushtet klimatike dhe cilësinë e ajrit të zonës?			
4.11	A janë përshkruar dhe kur nevojitet vlerësuar/matur ndikimet direkte në nivelet e zhurmës së zonës?			
4.12	A janë përshkruar dhe kur nevojitet vlerësuar/matur ndikimet direkte, të tilla si ndriçimi, rrezatimi elektromagnetik apo nxehtësia në zonë?			
4.13	A janë përshkruar dhe kur nevojitet vlerësuar/matur ndikimet direkte në shfrytëzimin e burimeve natyrore të parinovueshme lëndë fosile, minerale) etj ?			
4.14	A janë përshkruar ndikimet direkte në objektet me vlera kulturore në zonë?			
4.15	A janë përshkruar dhe kur nevojitet vlerësuar/matur ndikimet direkte në veçoritë e peizazhit?			
4.16	A janë përshkruar dhe kur nevojitet vlerësuar/matur ndikimet direkte në demografinë dhe kushtet socio-ekonomike të zonës?			
Parashikimi i ndikimeve indirekte/dytësore të përkohshme, afatshkurtra, të përhershme, afatgjata, aksidentale, indirekte dhe pasojave kumulative				
4.17	A përshkruhen ndikimet dytësore si pasojë e ndikimeve direkte të përshkruara më sipër dhe kur nevojitet të vlerësohen/maten (për shembull dëmtime në fauna, flora, habitate të shkatëruara nga ndotja e ujit dhe tokës, ajrit, zhurmës, ndikime në përdorimin e ujit të shkatëruara si pasojë e ndryshimeve në hidrologji për llogari të veprimtarisë, pasoja në vepra muzeale, arkeologjike si pasojë e gjurmëve në tokë etj).			
4.18	A përshkruhen ndikimet e përkohshme (me kohëzgjatje të vogël) gjatë veprimtarisë ndërtimore apo instalimit dhe çmontimit të pajisjeve?			
4.19	A përshkruhen ndikimet/pasojat e përhershme gjatë veprimtarisë ndërtimore apo instalimit dhe çmontimit të pajisjeve?			
4.20	A përshkruhen ndikimet afatgjata në mjedis gjatë gjithë ciklit të veprimtarisë si pasojë e çlirimit/shkarkimit në mjedis të ndotësve gjatë proceseve?			
4.21	A përshkruhen pasojat që mund të jenë rrjedhojë e aksidenteve gjatë veprimtarisë, ekspozimit ndaj veprimtarisë dhe kur është e nevojshme të maten/vlerësohen?			
4.22	A përshkruhen ndikimet e zhvendosura në distancë si pasojë e veprimtarisë, si p.sh. marrje e mineraleve larg vendndodhjes së veprimtarisë, hapja e rrugëve të reja, marrja e ujit dhe energjisë, shkarkimi i ujërave të ndotura apo mbetjeve që mund të japin efekte negative larg vendit ku prodhohen/gjenerohen etj.?			
4.23	A përshkruhen ndikimet negative si pasojë e zhvillimeve të nxitura apo stimuluar nga veprimtaria (veprimtari të tjera si pasojë e zhvillimit të infrastrukturës etj.?)			

4.24	A përshkruhen ndikimet kumulative të veprimtarisë si pasojë e bashkëveprimit edhe me ndikimet e tjera të veprimtarive ekzistuese apo të planifikuara në zonë?			
4.25	A identifikohen/përshkruhet shtrirja gjeografike në hapësirë, kohëzgjatja, frekuenca, kthyeshmëria dhe probabiliteti i shfaqjes së ndikimeve negative të veprimtarisë?			
Parashikimi i ndikimeve negative në shëndetin e njerëzve dhe zhvillimin e qëndrueshëm				
4.26	A përshkruhen/identifikohen ndikimet direkte dhe indirekte apo dytësore në shëndetin e njerëzve dhe mirëqenien e tyre si pasojë e veprimtarisë dhe kur është e nevojshme të maten/apo vlerësohen në terma sasiorë? (p.sh. ndikime në shëndet si pasojë e çlirimit të substancave toksike në mjedis, mbetjeve të rrezikshme, ndryshim të kushteve të jetës apo ndikime në grupe të caktuara vulnerabël)			
4.27	Nëse është e nevojshme, a trajtohen çështje të biodiversitetit, ndryshimet klimatike globale dhe zhvillimi i qëndrueshëm?			
Vlerësimi i rëndësisë/domethënies së pasojave/ose rëndësia				
4.28	A vlerësohet rëndësia (sa të dëmshme janë realisht ndikimet negative) të të gjitha ndikimeve të parashikuara më sipër në terma të përputhjes me legjislacionin, rëndësinë për receptorët si njerëzit dhe receptorët e tjerë të mjedisit të ndikuar?			
4.29	Nëse ndikimet e veprimtarisë janë vlerësuar për përputhshmërinë me standardet, legjislacionin, a janë krahasuar/referuar standardeve lokale, rajonale dhe ndërkombëtare dhe a janë marrë këto standarde si udhëzuese për veprimtarinë?			
4.30	A janë përshkruar ndikimet pozitive të veprimtarisë në mjedis me të njëjtën mënyrë si janë përshkruar ato negative?			
4.31	A përshkruhet në mënyrë të qartë rëndësia/signifikanca e secilit ndikim?			

Metodat e vlerësimit të ndikimit				
4.32	A përshkruhen metodat e planifikuara për vlerësimin e ndikimeve, arsyet e përzgjedhjes së tyre, vështirësitë e hasura, si dhe ndonjë pasiguri lidhur në rezultatet e nxjerra?			
4.33	Nëse ekziston ndonjë pasiguri (sipas pikës 4.32 më sipër) lidhur me veprimtarinë dhe ndikimet e saj në mjedis, a është parashikuar skenari më i keq i mundshëm?			
4.34	Nëse ka pasur vështirësi në sigurimin apo mbledhjen e të dhënave të nevojshme për parashikimin e ndikimeve, a janë përshkruar vështirësitë, si dhe implikimet e tyre të mundshme në rezultatet finale?			
4.35	A përshkruhet se mbi ç'bazë/kriter është bërë vlerësimi i rëndësisë/signifikances së ndikimeve?			
4.36	Ndikimet janë përshkruar duke marrë parasysh që janë zbatuar masat zbutëse, p.sh. a janë përshkruar ndikimet e mbetjeve?			
4.37	A është trajtuar në nivel profesional dhe të mjaftueshëm secili ndikim/pasojë lidhur edhe me rëndësinë e tij në vendimmarrje? A fokusohet trajtimi i ndikimeve në çështje të rëndësishme duke shmangur edhe informacionin e panevojshëm?			
4.38	A u jepet rëndësia e mjaftueshme në trajtim ndikimeve me pasoja të konsiderueshme/rëndësishme krahasuar me ndikimet më pak të rëndësishme?			

Pyetje të tjera lidhur me veprimtarinë/projektin				
SEKSIONI 5 – PËRSHKRIMI I MASAVE PËR ZBUTJEN E NDIKIMIT				
	Pyetja vlerësuese	PO	JO	Çfarë informacioni shtesë apo që mungon nevojitet?
5.1	A diskutohet/përshkruhet mundësia e zbutjes së pasojave të rëndësishme në mjedis si pasojë e ndikimit të veprimtarisë në çdo aspekt/media të mjedisit?			
5.2	A ka dhe përshkruhen qartë masat për zbutjen e ndikimeve bazuar në rëndësinë/domethënien që çdo ndikim paraqet lidhur me pasojat që shkakton në mjedis, si dhe a përshkruhet qartë efektshmëria e secilës pasojë?			
5.3	Nëse efektshmëria e masave zbutëse është e paqartë (pasigurt), a shpjegohen arsyet e pasigurisë?			
5.4	A është e qartë që zhvilluesi i veprimtarisë angazhohet të zbatojë masat zbutëse apo ato jepen thjesht si rekomandime apo sugjerime?			
5.5	A jepen nga zhvilluesi/propozuesi arsyet e përcaktimit të masave zbutëse të propozuara?			
5.6	A përcaktohen qartë përgjegjësitë e zbatimit apo dhe financimit të masave zbutëse të propozuara?			
5.7	Nëse masat për zbutjen e ndikimeve nuk janë praktikisht të realizueshme apo zhvilluesi/propozuesi nuk ka propozuar të tilla, a jepen shpjegohen qartë arsyet për të dy rastet?			
5.8	A vlerësohet/evidentohet se realizuesit e VNM (hartuesit të raportit të VNM) dhe zhvilluesit kanë konsideruar të gjitha mundësitë dhe teknikat e njohura për zbutjen e pasojave të ndikimeve, si analizën e alternativës, vendndodhjes, ndryshimeve/modifikimeve në projektin e veprimtarisë, ndryshime/modifikime në procese dhe metoda prodhimi, zgjidhje etj. Produkti apo mbetjet e një aktiviteti mund të jenë lëndë e parë ose shërbejnë për një aktivitet tjetër” masat korrigjuese apo riaftësuese/rehabilituese për të kompensuar ndikimet?			
5.9	A përshkruhen masat dhe përgjegjësitë për të monitoruar dhe ndikimet dhe pasojat e tyre?			
5.10	A jepet informacion/trajtohet/përshkruhen ndikimet negative të mundshme të vetë masave të propozuara?			
Pyetje të tjera lidhur me masat zbutëse				
SEKSIONI 6 PËRMBLEDHJA JOTEKNIKE (NË GJUHË TË KUPTUESHME)				
	Pyetja vlerësuese	PO	JO	Çfarë informacioni shtesë apo që mungon nevojitet?
6.1	A përfshihet një përmbledhje në gjuhë joteknike e raportit të VNM-së?			
6.2	A përmban përmbledhja joteknike një përshkrim të qartë dhe të plotë të veprimtarisë, vlerave të mjedisit në zonën e veprimtarisë, ndikimeve dhe pasojave të veprimtarisë në mjedis, si dhe masave për zbutjen e pasojave në mjedis?			
6.3	A përshkruhet në përmbledhjen joteknike, ndonjë pasiguri e rëndësishme për veprimtarinë dhe pasojat e saj në mjedis?			
6.4	A përshkruan përmbledhja joteknike procesin e vendimmarrjes dhe rolin e VNM-së në këtë proces?			
6.5	A përshkruhet në përmbledhjen joteknike në mënyrë të përmbledhur metodat e përqasjet për vlerësimin?			

6.6	A është shkruar përmbledhja në një gjuhë joteknike, duke shmangur terminologjinë teknike, të dhënat shkencore dhe diskutimet shkencore?			
6.7	A mund të kuptohet përmbledhja joteknike nëse i vihet në dispozicion të publikut?			
Pyetje të tjera lidhur me përmbledhjen joteknike				
SEKSIONI 7 – CILËSIA E PREZANTIMIT/PARAQITJES TË DOKUMENTEVE				
	Pyetja vlerësuese			Çfarë informacioni (shtesë apo që mungon) nevojitet?
8.1	A jepet qartë informacioni mjedisor në kuadër të veprimtarisë?			
8.2	A është organizuar dhe strukturuar logjikisht dokumentacioni përfshi edhe raportin e VNM-së, nga ku lexuesi mund të lokalizojë me lehtësi informacionin që përmbajnë?			
8.3	A përmbajnë dokumentet, përfshi edhe raportin e VNM-së, pasqyrën e lëndës për përmbajtjen e tyre në brendësi?			
8.4	A përshkruhet qartë procesi dhe etapat në kuadër të vlerësimit të ndikimeve të veprimtarisë?			
8.5	A janë paraqitur qartë dhe kuptueshëm informacioni, përfshi edhe atë të raportit të VNM-së duke shmangur informacionin dhe të dhënat e panevojshme dhe të papërshtatshme?			
8.6	A ilustrohen të dhënat dhe informacioni me tabela, grafikë, figura apo fotografi të cilat lehtësojnë të kuptuarin e lexuesit?			
8.7	A përdoren shtojca apo anekse për të ilustruar apo detajuar e referencuar përshkrimet në tekstin e dokumenteve të projektit, përfshi edhe raportin e VNM-së?			
8.8	A mbështeten në të dhëna konkrete konkluzionet dhe analizat përfundimtare të vlerësimit të ndikimit?			
8.9	A jepen referenca të të gjitha të dhënave të përdorura në kuadër të vlerësimit të ndikimit?			
8.10	A është përdorur terminologjia e njohur dhe e njëjtë nëpër të gjitha dokumentet e veprimtarisë?			
8.11	A është paraqitur materiali në një lidhje të vetme me referime ndërmjet pjesëve të tij për të ndihmuar shqyrtimin e materialit si një të tërë?			
8.12	A është/vlerësohet dokumentacioni është i saktë, i hartuar me objektiv dhe në mënyrë të paanshme?			
Pyetje të tjera lidhur me cilësinë e prezantimit/paraqitjes së dokumenteve				

SHTOJCA II

Në informacionin e dhënë në raportin e VNM-së duhet të përfshihen:

- Përshkrimi i karakteristikave fizike e veprimtarisë, përdorimi i tokës nga veprimtaria gjatë ndërtimit dhe ushtrimit të veprimtarisë;
- Përshkrim të proceseve kryesore të prodhimit dhe teknologjisë;
- Një vlerësim cilësor dhe sasior të shkarkimeve të pritshme në mjedis (ujë, ajër, ndotje e tokës, zhurmë dhe vibrim, ndriçim, rrezatim dhe nxehtësi) si pasojë e ushtrimit të veprimtarisë;
- Një trajtim i alternativave dhe arsyetimi i përzgjedhjes së secilës duke pasur në konsideratë edhe ndikimet/pasojat në mjedise respektive;

e) Një përshkrim të përbërësve të mjedisit që mund të ndikohen në mënyrë të rëndësishme nga veprimtaria e propozuar, duke përfshirë në veçanti, popullsinë, florën, faunën, tokën, klimën dhe ajrin, pasuritë natyrore dhe trashëgiminë arkeologjike e historike, peizazhin dhe ndërlidhjen e faktorëve të mësipërm.

f) Një përshkrim i ndikimeve/pasojave të rëndësishme në mjedis të veprimtarisë dhe si rezultat i ekzistencës/ndërtimit të projektit; përdorimit të burimeve natyrore; shkarkimeve në mjedis të ndotësve, si dhe prodhimi dhe asgjësimi i mbetjeve dhe i metodave të parashikimit e vlerësimit të pasojave në mjedis;

g) Një përshkrim i masave për parandalimin, zbutjen dhe, kur është e mundur, shmangien e ndikimeve me pasoja të rëndësishme në mjedis;

h) Një përmbledhje në gjuhë joteknike të çështjeve të mësipërme;

i) Një pasqyrim të vështirësive (mosnjohje teknike apo mungesë në njohuri) të hasura gjatë vlerësimit të ndikimit dhe hartimit të raportit të VNM-së.

SHTOJCA III

Vlerësimi përfundimtar i raportit të VNM-së

Vlerësimi i përgjithshëm i cilësisë së raportit të VNM-së			
Nr.	Rishikimi i çështjeve	Shkalla e vlerësimit (i plotë, me mangësi)	Komente
	Karakteristikat e projektit		
	Shqyrtimi i alternativave		
	Vendndodhja e projektit		
	Masat zbutëse		
	Karakteristikat e ndikimeve të mundshme		
	Prezantimi i raportit të VNM-së		
Vlerësimi i përgjithshëm:			
Komente:			

Plotësoi _____ data _____

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-eksponitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 5.8.2010

Doli nga shtypi më 7.8.2010

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 40 lekë